

SPECIFIKIME TEKNIKE

KOKA(TERMINALE) KABLLI TM

SPECIFIKIME KOKA(TERMINALE) KABLLI TM

Te pergjithshme

Te gjitha terminalet e kabllit 10 kV jane projektuar qe te jene te sigurta ne kushte klimatike te ndryshme pa pesuar demtime.

Terminalet e kabllit 10 kV duhet te jene te sigurta edhe kur jane ne ngarkese , nen tension apo nen veprimin e lidhjes se shkurter apo avarive te tjera qe mund te ndodhin ne sistem, ato duhet te sigurojne dhe punojne ne kushte optimale.

Kerkesa te detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi te siguroje:

- Certifikatat e prodhuesit ISO 9001
- Te dhena teknike si ne specifikime teknike
- Te gjitha test raportet e fabrikes
- Skicat dhe dimensionet
- Manual I perdorimit
- Te kene marketim CE

Kushtet e sistemit

Te dhena per sistemin

Specifikime	Njesia	Sistemi 10 kV
Tensioni nominal ne sistem	kV	10
Tensioni me i larte per paisjet	kV	12
Frekuenca e sistemit	Hz	50
Numri I fazeve		3
Sistemi I tokezimit		I izoluar

Kushtet atmosferike

Temperature maksimale e ambientit	40 °C
Temperatura maks. mesatare ditore	30 °C
Temperatura minimale e ambientit	-10 °C
Temperatura maks. ne siperfaqet e ekspozuara ne diell	60 °C
Lageshtia relative maks (ne toke)	95 %
Lageshtia relative maks (ne ajer)	80 %
Lartesia maksimale mbi nivelin e detit	<1000 m

Testet fizike dhe elektrike duhet te jene ne perputhje me standartet IEC ose ekuivalentet e tyre. Materialet duhet te jene sipas standartit ISO 9001 ose nje standart me i avancuar.

Standartet referuese

Terminalet e kabllit nje dhe terfaze 6, 10 kV duhet te jene conform kerkesave te standartit CENELEC HD 629, SSH EN 60137 , SSH EN 60502 ose ekuivalenete e tyre.

Testet

Testet duhet te kryhen ne perputhje sic specifikohet ne standartin CENELEC HD 629, SSH EN 61442 ose standarte te tjera ekuivalente.

Identifikimi dhe paketimi


Paketimi duhet te jete I projektuar ne menyre te tille qe te mbroje mallin nga hyrja e ujit dhe demtimet mekanike. Te gjitha pjeset perberese duhet te ruajne parametrat teknike ne temperaturat -5°C deri 40 °C. Cdo koke kablli te duhet te kete brenda amballazhimit udhezimet e instalimit, aplikimin, diapazonin e perdorimit si dhe emertimin dhe sasine e pjeseve perberese. Emertimet, diapazoni, emri firmes prodhuese duhet te jete i stamposur mbi cdo pjese perberese.

A. KOKA KABLLI PER KABLLO TE EKSPANIZUAR TRE FAZORE (3 DEJESH) ME IZOLIM POLIMER 10 kV

1. Terminale te brendeshme 10 kV, per kablo 3x ---- mm²

Ilustrim

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Pershkrim

Kablli duhet te transformohet ne pothuaj tre deje kablli te cilat lejojne kryqezimin e dejeve madje dhe ne hapësirat e mbyllura te lidhjes. Dejet duhet te mbulohen me tubin nga siperfaqja ku kablli eshte unik deri te skaji. Ne piken ku dejet ndahen vendoset materiali bllokues dhe ngjites. Trupi I terminalit(I termotkurrshem) duhet te kete nje shtrese kontrolli per te kryer kontrollin e fushes elektrike brenda te gjithe gjatesise se terminalit dhe nje shtrese izolimi ne formen e nje tubi me dy shtresa te stampuara qe ne prodhim per te mos lejuar fluska ajri midis tyre, qe ben te mundur mospasjen e zonave me gradiente te larte te fushes elektrike . Ngjitesi termoshkrires me shkriren e tij hermetizon skajet e kablrit me gushoren nga lageshtira dhe papastertite. Gushorja ben hermetizimin e gjithe kablrit.

Kapikordat ne forme syri duhet te jene prej materiali bimetalik (Al-Cu) dhe te jene brenda kompletit. Ato duhet te kene edhe bullonin dhe dadon per lidhje.

Me kerkese te vecante ku percaktohet dhe materiali Cu-Al ose Al, kapikordat mund te jene edhe ne forme kunj,

Bashkueset per tokezim per kabllo me armim duhen porositur te ndara.

Seti I terminaleve te furnizuara duhet te perfshije materialet per te tria fazet.

Gjatesite e dejeve mund te reduktohen ne varesi te kerkeses se vendit ku instalohen, minimum I gjatesise se dellit eshte 320 mm per $U = 10$ kV, 360 mm per $U = 20$ kV dhe 600 mm per $U = 35$ kV.


Perdorimi

Terminalet per ambient te brendeshem 10 kV jane ndertuar per kablo te ekranizuar me tri deje me veshje te jashtme plastike , te armuar ose jo ose mbrojtese shirit bakri.

2. Terminale te jashtme 10 kV, per kablo 3x ---- mm²

Ilustrim

(Ilustrimet dhe permasat jane orientuese)



Pershkrim

Kabli duhet te transformohet ne pothuaj tre deje kabli te cilat lejojne kryqezimin e dejeve madje dhe ne hapesirat e mbyllura te lidhjes. Dejet duhet te mbuloohen me tubin nga siperfaqja ku kabli eshte unik deri te skaji. Ne piken ku dejet ndahen vendoset materiali bllokues dhe ngjites. Trupi I terminalit(I termotkurrshem) duhet te kete nje shtrese kontrolli per te kryer kontrollin e fushes elektrike brenda te gjithe gjatesise se terminalit dhe nje shtrese izolimi ne formen e nje tubi me dy shtresa te stampuara qe ne prodhim per te mos lejuar fluska ajri midis tyre, qe ben te mundur mospasjen e zonave me gradiente te larte te fushes elektrike . Ngjitesi termoshkrires me shkrirjen e tij hermetizon skajet e kablrit me gushoren nga lageshtira dhe papastertite. Gushorja ben hermetizimin e gjithe kablrit.

Kapikordat ne forme syri duhet te jene prej materiali bimetalik (Al-Cu) dhe te jene brenda kompletit. Me kerkese te vecante ku percaktohet dhe materiali Cu-Al ose Al, kapikordat mund te jene edhe ne forme kunj,

Konstruksioni i terminaleve te jashtme duhet te shoqerohet me izolatorete(fustanella) qe instalohen mbi tubin e jashtem izolues.

Bashkueset per tokezim per kabllo me armim duhen porositur te ndara.

Seti I terminaleve te furnizuara duhet te perfshije materialet per te tria fazet.

Gjatesite e dejeve mund te reduktohen ne varesi te kerkeses se vendit ku instalohen, minimum I gjatesise se dellit eshte 320 mm for $U = 10$ kV 460 mm for $U = 20$ kV and 800 mm for $U = 35$ kV.

Perdorimi


Terminalet per ambient te jashtem 10 kV jane ndertuar per kablot te ekranizuar me tri deje me nje veshje te jashtme plastike , te armuar ose jo ose mbrojtese shirit bakri.

B. KOKA KABLLI PER KABLOT NJE DEJESH TE EKSPANIZUAR ME IZOLIM POLIMERIK

1. Terminale te brendeshem 10 kV

Ilustrim

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Pershkrim

Keto specifikime ju perkasin kerkesave per terminale (te termotkurrshem) te brendshme per kablot 1-dejesh te ekranuar XLPE alumini 10 kV.

Trupi I terminalit(I termotkurrshem) duhet te kete nje shtrese kontrolli per te kryer kontrollin e fushes elektrike brenda te gjithe gjatesise se terminalit dhe nje shtrese izolimi ne formen e nje tubi me dy shtresa te stampuara qe ne prodhim per te mos lejuar filluska ajri midis tyre, qe ben te mundur mospasjen e zonave me gradiente te larte te fushes elektrike. Ngjitesin termoshkrires me shkrijen e tij hermetizon skajet e kablrit nga lageshtira dhe papastertite.

Materiali nuk duhet te jete I levizshem, duhet te jete rezistent ndaj erozionit dhe rrezeve ultraviolet.

Hermetizimi I plote I kablrit , rrjetes prej bakri realizohet nepermjet perdorimit te mastikes se termotshkrishme ne te dy anet e terminalit. Ngjitesi I termoshkrishem I tubit te jashtem shkrin gjate instalimit dhe dhe mbush poret e kablrit duke u ngjitur me te dhe duke krijuar hermetizim te larte ndaj lageshtise, papastertive etj.

Ai gjithashtu permban nje shirit ne ngjyre te verdhe, i cili mbeshtillet perreth “shtreses gjysem percjellose izoluese”, per te siguruar mos shkarkimin ne kete zone si rezultat i hapësirave me ajer.

Kapikordat ne forme syri duhet te jene prej materiali bimetalik (Al-Cu) dhe te jene brenda kompletit. Me kerkese te vecante ku percaktohet dhe materiali Cu-Al ose Al, kapikordat mund te jene edhe ne forme kunjji,

Bshkueset per lidhjen me token do te porositen te ndara.

Seti I terminaleve te furnizuara duhet te perfshije materialet komplet per gjithe kabllin nje fazor.


Perdorimi

Terminalet e brendeshme jane ndertuar per kabllot e ekranizuar me nje dell me izolim plastic 10kV, dhe perdoren per ambiente te brendeshme.

2. Terminalet e jashtme 10 kV

Ilustrim

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Pershkrim

Ndertimi dhe instalimi eshte njesoj si tek terminalet e brendeshme.

Bashkueset per lidhjet e tokezimit do te porositen te ndara.

Fustanellat do te instalohen pergjate tubit .

Seti I terminaleve te furnizuara duhet te perfshije materialet komplet per gjithe kabllin nje fazor.

Perdorimi

Terminalet e jashtme jane ndertuar per kabllot e ekranizuar me nje dell me izolim plastic 10 kV dhe perdoren per ambient te jashtem.

Date, seal and Signature of
Tenderer:

DATA SCHEDULES

ITEM	DESCRIPTION	UNIT	required	func. Guarantee
I	MV Termination			
1	GENERAL DATA			
1.1	Applied standard			
1.2	Manufacturer			
1.3	Termination type			
1.4	Rated voltage	kV		
	Application			
1.5	Number of cores	pcs		
	Number of skirts	pcs		
1.6	Cross section of the termination	mm ²		
1.7	Diameter of the termination	mm		
1.8	Length of the termination	mm		
1.9	Type of the lug			
1.10	Material of the lug			
1.11	Cross section of the lug	mm ²		
1.12	Length of the lug	mm		

